

SKEDË INFORMUESE

Thirrjen e hapur për bashkitë për projekte që mbështesin ngritjen e kapaciteteve në fushën e projekteve rinore nën Programin Erasmus+

Projektet në thirrjen “Ngritja e Kapaciteteve në Fushën e Projekteve Rinore” të Programit të BE-së Erasmus+ janë projekte bashkëpunimi ndërkombëtar të bazuara në partneritete shumëpalëshe midis entiteteve aktive në fushën e rinisë në BE dhe vendeve të lidhura me Programin. Kjo thirrje synon ekskluzivisht vendet në Rajonin 1 (Ballkani Perëndimor). Projektet synojnë mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e të rinjve dhe të të mësuarit joformal, si një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe i mirëqenies.

Synimi i thirrjes:

Të rrisë kapacitetet e entiteteve rinore në vendet e Rajonit 1 (Ballkani Perëndimor), duke mbështetur përfshirjen e të rinjve në jetën demokratike, nxitjen e sipërmarrjes, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e metodave të reja të të mësuarit joformal.

Objektivat dhe fushat e ndërhyrjes:

- Rritja e kapaciteteve të entiteteve që punojnë me të rinjtë jashtë mësimit formal;
- Promovimi i mësimit joformal në organizatat që synojnë të rinjtë me më pak mundësi (përmes zhvillimit, testimit dhe lançimit të skemave dhe programeve të lëvizshmërisë së të mësuarit joformal në vendet partnere);
- Mbështetja e zhvillimit të punës për të rinjtë;
- Kontributi në promovimin dhe zbatimin e prioritetëve 'Angazho-Lidhu-Fuqizohu' të Strategjisë Rinore të BE-së (2019-2027) duke përfshirë 11 synimet evropiane për të rinjtë dhe Axhendën Evropiane të Punës Rinore;
- Nxitja e bashkëpunimit ndër-rajonal;
- Rritja e sinergjive dhe komplementaritetëve me sistemet e arsimit formal.

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- përmirësimi i përfshirjes së të rinjve në jetën demokratike, në drejtim të qytetarisë aktive dhe angazhimit me vendimmarrësit (fuqizimi, aftësitë e reja, përfshirja e të rinjve në hartimin e projekteve, etj.);
- përmirësimi i kapaciteteve sipërmarrëse dhe inovative të të rinjve;
- angazhimet transnacionale që sigurojnë gjithëpërfshirje, solidaritet dhe qëndrueshmëri;
- promovimi dhe kontributi në mësimin dhe bashkëpunimin transnacional ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve;
- rritja e praktikave ekzistuese dhe shtrirja përtej partneritetit, duke përfshirë përdorimin e mirë të mjeteve dixhitale për të qëndruar të lidhur në të gjitha rrethanat, edhe në situata të largësisë;
- lidhja e rezultateve me komunitetet lokale, duke krijuar mundësi punësimi dhe duke ushqyer ide novatore që mund të përsëriten dhe zgjerohen;

- demonstrimi i përfshirjes dhe aksesit të grupeve të synuara dhe individëve me më pak mundësi.

Fushat tematike:

Propozimet duhet të fokusohen në mbështetjen e entiteteve rinore që punojnë me të rinjtë jashtë mësimit formal në një ose më shumë nga fushat tematike të mëposhtme:

- pjesëmarrja politike, angazhimi qytetar dhe dialogu me vendimmarrësit;
- përfshirja e të rinjve me më pak mundësi;
- demokracia, sundimi i ligjit dhe vlerat, lidhshëria e të rinjve;
- fuqizimi / angazhimi / punësimi i të rinjve;
- paqja dhe pajtimi pas konfliktit;
- mjedisi dhe klima;
- kundërshtimi i diskriminimit dhe barazia gjinore;
- aftësitë dixhitale dhe sipërmarrëse.

Aktivitetet e pranueshme:

Aktivitetet e propozuara duhet të lidhen drejtpërdrejt me objektivat e përgjithshme dhe specifike të veprimit, d.m.th. ato duhet të korrespondojnë me një ose më shumë nga fushat tematike të listuara më sipër dhe duhet të detajohen në një përshkrim projekti që mbulon gjithë periudhën e zbatimit. Aktivitetet e pranueshme duhet të:

- kontribuojnë në inkurajimin e dialogut me politikën, bashkëpunimin, rrjetëzimin dhe shkëmbimin e praktikave;
- promovojë bashkëpunimin strategjik ndërmjet organizatave rinore nga njëra anë dhe autoriteteve publike;
- promovojë bashkëpunimin ndërmjet entiteteve dhe organizatave rinore aktive në fushën e arsimit dhe trajnimit si dhe me entiteteve aktive në tregun e punës;
- rrisin kapacitetet e këshillave rinore, platformave rinore dhe autoriteteve lokale, rajonale dhe kombëtare që merren me rininë, veçanërisht në vendet e treta të pranueshme që nuk janë të lidhura me Programin;
- rrisin menaxhimin, qeverisjen, kapacitetin e inovacionit, udhëheqjen dhe ndërkombëtarizimin e organizatave rinore, fushatat, si dhe zhvillimin e mjeteve të informacionit, komunikimit dhe medias;
- ndihmojnë organizatat rinore për të zhvilluar metoda, mjete dhe materiale të punës për të rinjtë, duke përfshirë iniciativat inkurajuese të bashkë-krijimit dhe bashkë-projektimit të projekteve, duke lejuar krijimin e projekteve me pjesëmarrje;
- ndihmojnë organizatat rinore për të krijuar forma të reja të ofrimit të punës rinore dhe ofrimin e trajnimit dhe mbështetjes; lehtësojnë lëvizshmërinë e të mësuarit joformal.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Aplikantët (përfituesit dhe subjektet e lidhura, nëse do të ketë) duhet të jenë:

- entitete juridike:

- OJQ (përfshirë OJQ-të evropiane rinore dhe Këshillat Rinorë kombëtarë) që punojnë në fushën e rinisë ose
- Organe publike në nivel vendor, rajonal ose në nivel kombëtar, që punojnë në fushën e Rinisë;
- Mund të marrin pjesë edhe organizata të tjera publike ose private, por jo si koordinatorë.

- të jenë të themeluara ligjërisht në një Shtet Anëtar të BE-së ose në një vend nga rajoni 1 (Ballkani Perëndimor).

E njëjta organizatë mund të paraqesë si **koordinator vetëm një aplikim për rajon brenda së njëjtës thirrje.**

Konsorciumi:

Propozimet duhet të dorëzohen nga një konsorcium prej të paktën **4 aplikantësh** (përfitues, subjekte jo të lidhura), i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- minimalisht 1 subjekt juridik nga një shtet anëtar i BE-së ose në një vend nga rajoni 1 (Ballkani Perëndimor);
- minimalisht 2 entitete juridike nga 2 vende në një vend nga rajoni 1 (Ballkani Perëndimor)
 - Entitetet nga rajone të ndryshme nuk mund të marrin pjesë në të njëjtat projekte. Projektet ndër-rajonale nuk janë të pranueshme. Subjektet e lidhura dhe partnerët e lidhur (Affiliated entities and associated partners) nuk llogariten për përbërjen e konsorciumit.

Aktivitetet duhet të zhvillohen në vendet e entiteteve aplikuese (koordinator, përfitues dhe subjekte të lidhura nëse ka).

Buxheti:

- Buxheti total i thirrjes është **3.500.000 Euro.**
- Kontributi maksimal i BE-së për projekt është **300.000 Euro.**

Granti do të jetë një grant lump-sum. Kjo do të thotë se do të rimbursojë një shumë fikse, bazuar në shumën e përgjithshme ose një financim që nuk lidhet me kostot. Shuma finale do të caktohet nga donatori në bazë të buxhetit të parashikuar të projektit dhe norma e financimit është **80%.**

Mbështetja financiare për palët e treta në formën e granteve ose çmimeve nuk lejohet. Shpenzimet e vullnetarëve nuk lejohen.

Kohëzgjatja e projekteve:

Projektet normalisht duhet të zgjasin nga 12 deri në 36 muaj (zgjatjet janë të mundshme, nëse justifikohen siç duhet).

Si bëhet aplikimi:

Aplikimet dërgohen përmes sistemit të BE-së Tenders and . Anekset që duhet të plotësohen dhe vendosen në sistem janë:

- Application Form Part A që plotësohet online
- Application Form Part B (Paketa e Application Form dhe Buxhetit) që shkarkohet, plotësohet dhe ngarkohet online
- Part C që plotësohet online

Kur është afati i fundit:

- Afati i fundit: **06 March 2025 17:00:00 Brussels time**

Linku i thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/ERASMUS-YOUTH-2025-CB-WB?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&programmePeriod=2021%20-%202027&frameworkProgramme=43353764&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!